**VENDIM**
**Nr.178, datë 29.3.2006**

# PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.161, DATË 21.3.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË BARNAVE, QË RIMBURSOHEN NGA INSTITUTI I SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE MASËN E MBULIMIT TË ÇMIMIT TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 15 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 4 e 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006" me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.161, date 21.3.2006, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në listen e barnave, që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, që i bashkëlidhet vendimit, çmimet e barnave me kod bari, përkatësisht: 19/93, 19/11, 19/39, 20/93, 20/11, 20/39, 21/93, 21/11, 22/93, 23/93, 24/93, 24/39 dhe 25/93, ndryshojnë dhe bëhen sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pasqyra III, që i bashkëlidhet vendimit, shtohet sipas pasqyrës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LISTA E BARNAVE TE RIMBURSUARA 2006

| KodBari | KodiATC | EmertimiKimik | Forma | EmriTregtar | Firma | Cmimi Ref | Cmimi Pac. | Rimb. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | TRAKTI DIGJESTIV DHE METABOLIZMI | | | | | | | |
| A10 | ANTIDIABETIKET | | | | | | | |
| 19/93 | A10AB01 | Insuline Humane Biosintetike Neutrale 100 Nj.N. / ml - 3 ml | pen | Actrapid HM | NOVO NORDISK | 802.5 | 40.1 | 762.4 |
| 19/11 | A10AB01 | Insuline Humane Biosintetike Neutrale 100 Nj.N. / ml - 3 ml | optiset | Insuman Rapid | AVENTIS | 896.5 | 134.1 | 762.4 |
| 19/39 | A10AB01 | Insuline Humane Biosintetike Neutrale 100 Nj.N. / ml - 3 ml | pen | Humajet R | ELI LILLY | 957.4 | 195.0 | 762.4 |
| 20/93 | A10AC01 | Insuline Humane Biosintetike Izofane 100 Nj.N. / ml - 3 ml | pen | Insulatard HM | NOVO NORDISK | 802.5 | 40.1 | 762.4 |
| 20/11 | A10AC01 | Insuline Humane Biosintetike Izofane 100 Nj.N. / ml - 3 ml | optiset | Insuman Basal | AVENTIS | 896.5 | 134.1 | 762.4 |
| 20/39 | A10AC01 | Insuline Humane Biosintetike Izofane 100 Nj.N. / ml - 3 ml | pen | Humajet NPH | ELI LILLY | 957.4 | 195.0 | 762.4 |
| 21/93 | A10AD01 | Insuline Humane Biosintetike Bifazike Izofane 100 Nj.N/ ml - 3 ml 50/50 | pen | Mixtard 50 HM | NOVO NORDISK | 802.5 | 40.1 | 762.4 |
| 21/11 | A10AD01 | Insuline Humane Biosintetike Bifazike Izofane 100 Nj.N/ ml - 3 ml 50/50 | optiset | Insuman Co 50/50 | AVENTIS | 896.5 | 134.1 | 762.4 |
| 22/93 | A10AD01 | Insuline Humane Biosintetike Bifazike Izofane 100 Nj.N/ ml - 3 ml 10/90 | pen | Mixtard 10 | NOVO NORDISK | 802.5 | 40.1 | 762.4 |
| 23/93 | A10AD01 | Insuline Humane Biosintetike Bifazike Izofane 100 Nj.N/ ml - 3 ml 20/80 | pen | Mixtard 20 HM | NOVO NORDISK | 802.5 | 40.1 | 762.4 |
| 24/93 | A10AD01 | Insuline Humane Biosintetike Bifazike Izofane 100 Nj.N/ ml - 3 ml 30/70 | pen | Mixtard 30 HM | NOVO NORDISK | 802.5 | 40.1 | 762.4 |
| 24/39 | A10AD01 | Insuline Humane Biosintetike Bifazike Izofane 100 Nj.N/ ml - 3 ml 30/70 | pen | Humajet M3 | ELI LILLY | 957.4 | 195.0 | 762.4 |
| 25/93 | A10AD01 | Insuline Humane Biosintetike Bifazike Izofane 100 Nj.N/ ml - 3 ml 40/60 | pen | Mixtard 40 HM | NOVO NORDISK | 802.5 | 40.1 | 762.4 |

PASQYRA I

MARZHI I GROSISTIT 12%, I FARMACISË 24%.

| | | | |
|---|---|---|---|
| 19 | A10AD01 | Insuline Humane Biositetike Neutrale 100 Nj.N/ ml- 3m1 | pene |
| 20 | A10AD01 | Insuline Humane Biositetike Izofane 100 Nj.N/ ml- 3m1 | pene |
| 24 | A10AD01 | Insuline Humane Biositetike Biofazike Izofane 100 Nj.N/ ml- 3m1 | pene |